**VENDIM**
**Nr.55, datë 3.2.1997**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.38, DATË 15.1.1996 "PËR DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK"**

Me propozimin e Kryetarit të Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.38, datë 15.1.1996 "Për deklarimin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa drejtuesve të shërbimit publik", në pikën 12 shkronja "e" shtohet ky paragraf:

"Deklaratës i bashkëngjitet edhe certifikata e gjendjes familjare që sigurohet nga vetë deklaruesi (origjinale ose fotokopje e noterizuar), e cila duhet të pasqyrojë gjendjen dhe ndryshimet për të 12 muajt e vitit, për të cilët deklarohet pasuria".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
**Aleksandër Meksi**